




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

PLANI VJETOR I AUDITIMIT 2025/2026

(për sezonin auditues - 2025/2026)



Prishtinë, tetor 2025

TABELA E PËRMBAJTJES

1.FJALOR I SHPREHJEVE	3
2.VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT	4
3.HYRJE.....	6
4.AUDITIMET - LLOJET DHE PROCESI I AUDITIMEVE	7
5.OBJEKTIVAT E PLANIT VJETOR TË AUDITIMIT	12
6.BUXHETI DHE BURIMET NJERËZORE	23
7.ZBATIMI I PLANIT VJETOR	24
Shtojca 1. Subjektet/temat dhe shuma e buxhetit që do të auditohet.	25

1. FJALOR I SHPREHJEVE

ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit
AP	Auditori i Përgjithshëm
RVA	Raporti Vjetor i Auditimit
PVA	Plani Vjetor i Auditimit
ISA	Institucioni Suprem i Auditimit
RFV/BK	Raporti Financiar Vjetor i Buxhetit të Kosovës
PFV	Pasqyrat Financiare Vjetore
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
SITA	Sistemi Informativ i Teknologjisë së Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (ONISA)
KMFP	Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
USAID	Agjencia e Shteteve të zhvilluara për zhvillim ndërkombëtar
UN Women	United Nations Women
NP	Ndërmarrje Publike
OJQ	Organizata JoQeveritare
OB	Organizata Buxhetore
KRM	Kompania Rajonale e Mbeturinave
DEMOS	Programi për Decentralizim dhe mbështetje komunale
KOSTT	Korporata e transmisionit, sistemit dhe tregut të energjisë elektrike
SH.A	Shoqëri Aksionare
KRU	Kompania Regjionale e Ujit
MM	Ministria e Mbrojtjes
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MBZHR	Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MASHT	Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit
AKK	Agjencioni Kadastral i Kosovës
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MMPHI	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
ASHI	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit
MD	Ministria e Drejtësisë
NPH	Ndërmarrja Publike Hidroekonomike
ZRRE	Zyra e Rregullatorit për Energji
KPMM	Komisioni i Pavarur Për Miniera dhe Minerale

2. VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT



VIZIONI

Institucion Suprem i Auditimit i besueshëm dhe model, që i shton vlerë përdorimit të fondeve publike.



MISIONI

Nëpërmjet auditimeve cilësore ofrojmë siguri në shfrytëzimin e pasurive dhe parasë publike, me qëllim të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve për qytetarët dhe rritjen e llogaridhënies publike.



VLERAT E ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT (ZKA)

Pavarësia

Pavarësia nënkupton që i gjithë procesi i auditimit t'i nënshtrohet vetëm kërkesave të standardeve profesionale dhe të jetë jashtë ndikimit të palëve të treta. Pavarësia është elementi kryesor për të siguruar besimin e publikut dhe të Kuvendit të Kosovës, duke u ofruar atyre informacione të besueshme dhe të paanshme.

Profesionalizmi

ZKA-ja udhëhiqet në veprimtarinë e saj audituese nga standardet profesionale të ONISA-së dhe nga praktikat më të mira të vendeve.

Integriteti

ZKA-ja angazhohet për mishërimin e vlerave më të mira etike, profesionale dhe morale. Veprimtaria e auditimit kryhet në mënyrë të ndershme dhe jashtë çdo konflikti të interesit.

Transparenca

ZKA-ja është organizatë e hapur dhe do t'i bëjë publike të gjitha aktivitetet e saj të rëndësishme. Po ashtu do t'i ofrojë publikut të gjerë informacionin e përfituar nga auditimi, në përputhje me rregullat ligjore dhe standardet profesionale. ZKA-ja angazhohet që të promovojë transparencën edhe në subjektet e audituara, si një element i qeverisjes së mirë.

Fryma ekipore

Në ZKA procesi i auditimit kryhet në mënyrë profesionale dhe bashkëpunuese në mes kolegëve në ekip dhe në nivele të ndryshme organizative, kështu promovojmë frymën ekipore si vlerë e shtuar për ZKA-në.

3. HYRJE

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) si Institucion Suprem i Auditimit (ISA) kryen auditimin e jashtëm të sektorit publik në Republikën e Kosovës. Mandati dhe kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm janë përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

ZKA-ja auditon Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) të të gjitha organizatave buxhetore për të vlerësuar nëse ato ofrojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë dhe nëse paraja publike është shpenzuar për qëllimet për të cilat është miratuar. ZKA-ja kryen auditime të pajtueshmërisë për t'u ofruar përdoruesve të synuar informacione për atë nëse organizatat buxhetore të audituara i përmbahen ligjeve, akteve legjislative, politikave, udhëzuesve, vendimeve, kodeve të vendosura, standardeve dhe kushteve të dakorduara të kontratave dhe memorandumëve të mirëkuptimit. Përveç kësaj kryen edhe auditime të performancës me synim të përmirësimit të shërbimeve për qytetarët dhe vlerës për para.

Ligji Nr.05/L-055 për ZKA-në, respektivisht neni 20, përcakton që AP-ja të hartojë Planin Vjetor të Auditimit (PVA), i cili përfshin të gjitha aktivitetet audituese për sezonin auditues dhe dorëzohet të Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike (KMFP), për çdo vit deri më 31 tetor të vitit përkatës.

Në hartimin e këtij dokumenti është vepruar në përputhje me Ligjin e ZKA-së në përmbushjen e obligimeve kushtetuese e ligjore për auditime të rregullsisë¹.

Përzgjedhja e temave për auditime të performancës është bazuar në vlerësimin e ndikimit, në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve, përmirësimin e qeverisjes dhe mundësinë që të shtojë vlerë në menaxhimin e financave publike. Si proces i rregullt në konsultime me shoqërinë civile dhe OJQ-në është vlerësuar niveli i rrezikut (qasjen e bazuar në rrezik).

Përzgjedhja e 10 auditimeve të ndërmarrjeve publike përfshinë 8 NP që kanë qenë subjekt i auditimit edhe vitin e kaluar, nga të cilat 4 kanë marrë opinion të kualifikuar dhe 4 kanë marrë opinion të kundërt, si dhe 2 ndërmarrje të tjera, KRM Pastërtia-Ferizaj dhe Stacioni i autobusëve-Prishtinë, të cilat janë audituar nga ZKA-ja disa vite më parë.

Auditimi i ndërmarrjeve publike zakonisht bëhet duke u bazuar në disa elemente kryesore si: ujë, energji, transport apo shërbime higjienike, pra ndërmarrjet që ofrojnë shërbime të ndjeshme për publikun dhe kanë ndikim të madh në jetën e përditshme të qytetarëve. Ato janë në pronësi publike dhe zakonisht menaxhojnë buxhete ose kanë shpenzime me vlera të larta. Po ashtu, auditimi mund të bëhet për shkak të çështjeve të evidentuara në auditime të mëparshme ose me kërkesë të Kuvendit të Kosovës.

Plani Vjetor i Auditimit përmban informatat relevante në lidhje me auditimet e përzgjedhura nga Auditorja e Përgjithshme për sezonin auditues, përfshirë: projektet, aktivitetet, afatet, burimet e nevojshme, buxhetin, rezultatet dhe rreziqet që mundet të ballafaqohet ZKA-ja.

¹ Megjithëse në ligjin për ZKA-në përdoret termi auditim i rregullsisë, sipas SNISA-ve të përditësuara nuk përdoret me tutje ky term. Ky lloj i auditimit tashmë emërtohet me termin Auditimi Financiar dhe i Pajtueshmërisë, pasi që SNISA i trajtojnë ndaras auditimet financiare nga ato të pajtueshmërisë.

Auditimet do të realizohen në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ("SNISA"), dhe Kornizën e Deklarimeve Profesionale (IFPP). Po ashtu, procesin e auditimit e bazojmë në parimet universale të ISA-ve dhe të Zyrës Kombëtare të Auditimit siç janë: pavarësia, profesionalizmi, integriteti, transparenca dhe fryma ekipore. Të gjitha raportet e ZKA-së janë të qasshme për palët e interesuara dhe publikohen në faqen zyrtare të internetit të ZKA-së.

4. AUDITIMET - LLOJET DHE PROCESI I AUDITIMEVE

Sipas Standardave Ndërkombëtare të Insitucioneve Supreme të Auditimit, Deklaratës Profesionale të INTOSAI-t standardi 100, njihen tre lloje të auditimeve të sektorit publik: auditime financiare, auditime të pajtueshmërisë dhe auditime të performancës.

4.1. Llojet e auditimeve

Në përputhje me mandatin dhe fushëveprimin e ZKA-së, gjatë sezonit 2025/26 do të kryhen këto lloje të auditimeve:



Auditimi financiar dhe i pajtueshmërisë përfshin auditimin e pasqyrave financiare vjetore të institucionit me qëllim të vlerësimit nëse raportet financiare:

- janë të besueshme dhe pasqyrojnë rezultatet e realizimit të buxhetit në mënyrë të drejtë;
- i përmbahen ligjeve dhe akteve nënligjore të zbatueshme dhe nëse fondet përdoren për qëllimet e synuara;
- lidhur me sistemin emenaxhimit financiar, funksionet e auditimit të brendshëm dhe sistemet e kontrollit të brendshëm funksionojnë.

Objektivat e auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë përkufizohen si siguri e arsyeshme, e cila u ofrohet shfrytëzuesve të Pasqyrave Financiare, nëse Pasqyrat Financiare të audituara janë në tërë kuptimin

² Auditimet e pasqyrave financiare për qëllime të veçanta kryhen në përputhje me SNA 800 dhe 805

material të vërteta dhe të drejta (apo të paraqitura drejt) dhe nëse transaksionet e raportuara në ato pasqyra janë kryer në pajtueshmëri me autoritetet³.

Në Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe ZKA-në ky lloj auditimi është përcaktuar si auditim i detyrueshëm i rregullsisë dhe me qëllim të përmbushjes së kësaj kërkesë, ky auditim nënkupton auditimin financiar të kombinuar me auditimin e pajtueshmërisë.

Auditimi financiar dhe i pajtueshmërisë kryhet çdo vit. Procesi i auditimit fillon në shtator, ndërsa raportet e auditimit mandatore për OB-të individuale dhe ndërmarrjet publike publikohen deri në fund të muajit qershor. Cikli i auditimeve përmbyllet në fund të muajit gusht kur Raporti Vjetor i Auditimit (RVA) për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës (RFV/BK) dorëzohet në Kuvendin e Kosovës. Pavarësisht nga burimi i kriterëve, auditori kryen auditimin dhe formon një opinion me nivelin e zgjedhur të sigurtë, në përputhje me kërkesat në SNISA 2000⁴.

Auditimi i pajtueshmërisë - Objektivi i auditimit të pavarur të pajtueshmërisë është t'u ofrojë përdoruesve të synuar informacione për atë nëse entitetet publike të audituara i përmbahen ligjeve, akteve legjislative, politikave, udhëzuesve, vendimeve, kodeve të vendosura, standardeve dhe kushteve të dakorduara të kontratave dhe memorandumëve të mirëkuptimit.

Auditimi i pajtueshmërisë përfshin aspektet e rregullsisë (respektimi/bindja me kriteret formale siç janë ligjet, rregulloret dhe marrëveshjet përkatëse) dhe/ose konformitetit (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publikë). Pavarësisht nga burimi i kriterëve, auditori kryen auditimin dhe formon një përfundim me nivelin e zgjedhur të sigurtë, në përputhje me kërkesat në SNISA 4000⁵.

Auditimi i performancës paraqet një shqyrtim të pavarur, objektiv dhe të besueshëm nëse angazhimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat janë duke vepruar në përputhje me parimet e:

- **ekonomicitetit** (minimizimi i kostove të burimeve);
- **efikasitetit** (përfitimi sa më i madh nga burimet në dispozicion); dhe
- **efektivitetit** (përmbushja e objektivave të përcaktuara dhe rezultateve të synuara).

Fushat, objektivat, koha e auditimit dhe e raportimit përcaktohen prej rastit në rast, duke u bazuar në rëndësinë, rrezikun, fushëveprimin e auditimit, kapacitetet ekzistuese si dhe kriteret tjera përkatëse.

Auditimi i performancës fokusohet në atë se si organizatat e sektorit publik i kanë përdorur burimet në dispozicion për t'i arritur objektivat e tyre. Për ekzaminimin e performancës së entitetit të audituar, ZKA-ja ndjek një tërësi ose një kombinim të këtyre tri qasjeve:

- qasjen e orientuar në **rezultate**, e cila vlerëson nëse janë arritur objektivat e paracaktuara;

3 "Pajtueshmëri me autoritetet" do të thotë pajtueshmëri me aktet apo rezolutat e legjislaturës apo instrumente tjera statutores, direktiva dhe udhëzues të nxjerra nga organet e sektorit publik me kompetenca të përcaktuara me statut, të cilave pritet t'i përmbahet entiteti i audituar. Thënë ndryshe, është pajtueshmëri me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikën e mira.

4 Auditimi Financiar (Parimet e AF-së SNISA 200-299, Standardet e AF SNISA 2000-2899, Udhëzimi Plotësues i AF GUID 2900-2999)

5 Auditimi i pajtueshmërisë (Parimet e AP-së SNISA 400-499, Standardet e AP SNISA 4000-4899, Udhëzimi plotësues i AP 4900-4999).

- qasjen e orientuar në **problem**, e cila verifikon dhe analizon shkaqet e problemit/eve;
- qasjen e orientuar në **sistem**, e cila ekzaminon funksionimin e sistemeve menaxhuese.

Në kuadër të auditimit të performancës përfshihet edhe Auditimi i teknologjisë së informacionit (TI-së), që definohet si ekzaminim dhe rishikim i sistemeve të TI-së dhe kontrollet e ndërlidhura me to, për të përfutur siguri ose për të identifikuar rreziqet lidhur me parimet e ligjshmërisë, efikasitetit, ekonomicitetit dhe efektivitetit të sistemeve të TI-së dhe kontrolleve lidhur me këto sisteme. Pavarësisht nga burimi i kriterëve, auditori kryen auditimin dhe formon një përfundim me nivelin e zgjedhur të sigurisë, në përputhje me kërkesat në SNISA 3000⁶.

4.2. Procesi i auditimeve

A. Procesi i auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë bazohet në metodologjinë e auditimit të përshkruar në Doracakun e Auditimit Financiar dhe të Pajtueshmërisë (Metodologjia e qasjes së kombinuar) dhe SNISA-t. Auditimi i rregullsisë kryhet nëpër disa hapa duke filluar nga njohja e entitetit dhe analiza e rreziqeve dhe vazhdon me:

- planifikimin e auditimit;
- ekzekutimin e auditimit;
- dhënien e konkluzioneve dhe opinionit të auditimit, raportimin në Kuvend dhe informimin e opinionit publik (publikimi i raporteve); dhe
- përcjelljen e adresimit të rekomandimeve të auditimit (plani i veprimit).

Grafiku 1: Fazat e procesit të auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë.



⁶ Auditimi i Performancës (Parimet e AP SNISA 300-399, Standardet e AP SNISA 3000-3899, Udhëzuesi plotësues i AP GUID 3900-3999).

Faza 1. Planifikimi përfshin dy periudha:

- **Planifikimi i përgjithshëm i auditimit** ka për qëllim mbledhjen e sa më shumë informacioneve lidhur me entitetin që auditohet, gjë që realizohet në mënyrë efektive përmes punës përgatitore dhe takimeve me menaxhmentin e lartë të entitetit.
- **Planifikimi i detajuar i auditimit** përfshin zhvillimin e një plani të qartë dhe të strukturuar, i cili bazohet në analizën fillestare, vlerësimin e rreziqeve dhe të sistemit të kontrollit të brendshëm. Në këtë fazë përcaktohen objektivat specifike të auditimit, fushat me prioritet të lartë dhe procedurat thelbësore që do të zbatohen. Qëllimi është të sigurohet që auditimi të kryhet në mënyrë efektive dhe efikase, duke mbështetur arritjen e rezultateve të besueshme. Të gjitha këto përfshihen dhe dokumentohen në Memorandumin e Planifikimit të Auditimit.

Faza 2. Ekzekutimi i auditimit përfshin zbatimin praktik të planit të auditimit, ku auditorët mbledhin, testojnë dhe analizojnë dëshmitë për të vlerësuar funksionimin e kontrolleve dhe besueshmërinë e informacionit financiar apo operacional. Në këtë fazë realizohen testet thelbësore dhe analitike për të konfirmuar gjetjet. Rezultatet paraprake diskutohen me menaxhmentin për sqarime dhe komente. Përfundimet dhe vlerësimet përmbledhen në draft raportin e auditimit, i cili paraqet gjetjet, rekomandimet dhe vlerësimin e përgjithshëm të performancës dhe kontrollit të brendshëm të entitetit.

Faza 3. Raportimi përfshin përmbledhjen dhe finalizimin e konkluzioneve të auditimit, të bazuara në dëshmitë e mbledhura gjatë fazës ekzekutive. Në këtë fazë, auditorët hartojnë raportin përfundimtar të auditimit, i cili përfshin opinionin zyrtar mbi Pasqyrat Financiare dhe vlerësimin e pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret përkatëse. Raporti i nënshtrohet procesit të kontrollit të cilësisë dhe aprovimeve zyrtare brenda institucionit të auditimit, për të siguruar saktësi dhe objektivitet. Pas miratimit, raporti publikohet dhe u dërgohet autoriteteve relevante dhe palëve të interesit, duke përmbyllur kështu ciklin e auditimit me opinione dhe konkluzione zyrtare që reflektojnë gjendjen reale të entitetit të audituar.

Faza 4. Përcjellja e rekomandimeve të auditimit realizohet përmes auditimeve pasuese, me qëllim të verifikimit të zbatimit të tyre nga ana e entitetit të audituar. Pas pranimit të raportit final të auditimit, entiteti është i obliguar të hartojë planin e veprimit, ku përcakton masat dhe afatet për zbatimin e rekomandimeve, dhe ta dërgojë atë në Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA) brenda afatit të përcaktuar.

B. Procesi i auditimit të performancës dhe të pajtueshmërisë bazohet në metodologjinë e auditimit të përshkruar në Doracakun e Auditimit të Performancës dhe SNISA-t. Auditimi i performancës dhe ai i pajtueshmërisë kanë qasje të njëjtë dhe kryhet nëpër fazat në vijim:

Grafiku 2: Fazat e procesit të auditimit të performancës dhe të pajtueshmërisë



Faza 1. Planifikimi përfshin propozimin e temave për auditim dhe përgatitjen e memove parastudimore. Propozimet vlerësohen sipas rëndësisë, ndikimit dhe përshtatshmërisë së tyre për auditim. Gjatë kësaj faze, ekipi i auditimit zhvillon një analizë fillestare për të kuptuar më mirë fushën që do të auditohet. Në këtë kuadër, përcaktohet qartë problemi i auditimit, qëllimi dhe objektivat, si dhe fushëveprimi dhe motivi i auditimit, për të siguruar që procesi të jetë i fokusuar, i qëllimshëm dhe në përputhje me standardet profesionale.

Faza 2. Faza ekzekutive e auditimit përfshin zbatimin praktik të planit të auditimit për të mbledhur dëshmi të mjaftueshme dhe të besueshme. Gjatë kësaj faze, ekipet e auditimit testojnë proceset, analizojnë të dhënat dhe shqyrtojnë kontrollin e brendshëm për të vlerësuar performancën e entitetit. Auditorët kryejnë procedura të ndryshme, përfshirë verifikime, intervista dhe analiza krahasuese. Qëllimi është të identifikohen mangësitë, rreziqet dhe mundësitë për përmirësim. Të gjitha gjetjet dokumentohen me kujdes për të mbështetur konkluzionet. Në përfundim, hartohet draft-raporti i auditimit me gjetjet dhe rekomandimet paraprake.

Faza 3. Raportimi përfshin përfundimin dhe paraqitjen e gjetjeve të auditimit në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme. Ekipi i auditimit përgatit raportin përfundimtar, i cili duhet të jetë objektiv, i saktë, gjithëpërfshirës dhe i bazuar në dëshmi. Para publikimit, raporti i nënshtrohet kontrollit të cilësisë dhe aprovimeve zyrtare, për të siguruar që përmbajtja e tij është e drejtë dhe profesionale. Pasi të miratohet, raporti bëhet publik dhe u dërgohet palëve të interesit, duke përmbyllur kështu procesin e auditimit të performancës.

Faza 4. Përcjellja e auditimit ndodh pas kalimit të një periudhe të caktuar kohore, kur Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA-ja) mund të vlerësojë se sa progres ka bërë entiteti në zbatimin e rekomandimeve të dhëna. Ky vlerësim bëhet përmes një auditimi përcjellës, i cili synon të konfirmojë nëse veprimet e ndërmarra janë efektive dhe të qëndrueshme. Sipas standardeve të auditimit dhe Doracakut për auditimet e performancës, auditimet përcjellëse nuk kryhen domosdoshmërisht për çdo auditim të

mëparshëm. Vendimi për ta zhvilluar një auditim përcjellës merret në bazë të rëndësisë dhe ndikimit të temës së auditimit.

Procesi i auditimit financiar dhe i pajtueshmërisë në ZKA monitorohet dhe rishikohet nga Departamenti për Sigurimin e Cilësisë, i cili ka përgjegjësi të sigurojë që auditimet të jenë kryer në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Auditori i Përgjithshëm dhe me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Ky proces ndihmon në ruajtjen e cilësisë, profesionalizmit dhe besueshmërisë së punës audituese.

5. OBJEKTIVAT E PLANIT VJETOR TË AUDITIMIT

Zyra Kombëtare e Auditimit planifikon punën audituese në baza vjetore, e cila bazohet në objektivat e Planit Strategjik. Objektivat e ZKA-së për sezonin auditues 2025/26 janë në përputhje me kërkesat ligjore, të cilat synojnë rritjen e ndikimit në përmirësimin e qeverisjes dhe mundësinë për të shtuar vlerë në menaxhimin e financave publike.

Në sezonin auditues 2025/2026 janë planifikuar 145 auditime. Plani auditues përfshin:




Tabela 1: Numri dhe lloji i auditimeve të planifikuara për sezonin e auditimit 2025/2026

Llojet e auditimit					
Auditime të rregullsisë (financiare dhe pajtueshmërisë)	Numri	Auditime të pajtueshmërisë/klasifikuara	Numri	Auditime të performancës	Numri
Buxheti i Kosovës-RVA	1	Auditime të pajtueshmërisë	10	Auditime të performancës	20
Institucione të nivelit qendror	49	Auditime të pajtueshmërisë vazhdim nga viti paraprak	3	Auditime të performancës vazhdim nga viti paraprak	3
Komuna	38	Auditime të klasifikuara	3		
Ndërmarrje publike	12				
Projekte të financuara nga fondet e jashtme	6				
Gjithsej	106	Gjithsej	16	Gjithsej	23
Gjithsej numri i auditimeve për sezonin 2025/2026					145

Të gjitha auditimet (me përshkrim) janë paraqitur në **Shtojcën 1** të këtij dokumenti.

Raportet individuale për auditimet e rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë) do të finalizohen deri më 30 qershor 2026, në përputhje me afatin ligjor. Raporti Vjetor i Auditimit për Buxhetin e Kosovës pritet t'i dorëzohet Kuvendit të Kosovës jo më vonë se 31 gusht të vitit 2026.

Auditimet e performancës, pajtueshmërisë dhe të projekteve do të publikohen sipas kalendarit kohor të përcaktuar dhe aprovuar nga Auditori i Përgjithshëm.

Angazhimi i burimeve njerëzore në procese audituese është bërë duke marrë parasysh: disponueshmërinë me burime njerëzore, kualifikimin dhe përvojën e stafit, madhësinë e buxhetit që auditohet, rrezikshmërinë, si dhe kompleksitetin e temës audituese.

5.1. Objektivi i auditimeve të rregullsisë

Përveç auditimeve të rregullta vjetore, menaxhmenti i ZKA-së ka vendosur që në planin vjetor të auditimit të përfshijë 10 auditime të pajtueshmërisë, si dhe 2 auditimet e pasqyrave për qëllime të veçanta për nevojat e ZRRE-së dhe KPMM-së për ndërmarrjen publike KEK.

Për dallim nga viti i kaluar kemi zvogëluar kontraktimin e auditimit të Institucioneve të Pavarura prej 10 sa ishin, tani janë 6 të kontraktuara, ndërsa te komunat është rrit numri i auditimeve nga 10 të kontraktuara sa ishin, tani i kemi planifikuar 14. Auditimi i 6 institucioneve të pavarura dhe 14 komunave do të përkrahet nga një kompani private e auditimit, përderisa monitorimi i tyre dhe opinioni i auditimit përcaktohet nga Auditori i Përgjithshëm bazuar në metodologjinë e ZKA-së dhe SNISA-ve.

ZKA-ja ka mekanizma të brendshëm në funksion të trajtimit të kërkesave të ndryshme që vijnë nga palët e jashtme për auditime me kërkesë, dhe si të tilla trajtohen në mënyrën efektive.

Mënyra e përzgjedhjes së auditimeve të rregullsisë.

Përveç auditimeve të detyrueshme të rregullsisë të përcaktuar me ligj, fokus i veçantë i është dhënë auditimeve të pajtueshmërisë, ndërmarrjeve publike dhe projekteve të Bankës Botërore.

Fushëveprimi i auditimit apo qasja e auditimit nuk do të ndryshojë nga vitet paraprake, por do të ketë fokus më të madh në fushat që mund të pritet apo vlerësohet që mund të jenë më me rrezik dhe të kenë ndonjë shmangie nga rregullativa ligjore.

Planifikimi i auditimit është pjesë shumë e rëndësishme e procesit të auditimit, për arsye se i jep drejtim auditimit, duke u bazuar në një vlerësim të rreziqeve që kanë të bëjnë me entitetin, prandaj, një auditim efektiv dhe efikas mbështetet mbi planifikimin në mënyrën e duhur të proceseve dhe procedurave.

Ne kemi zhvilluar një strategji dhe qasje të detajuar për punën specifike, në mënyrë që auditimi të kryhet në mënyrë efektive dhe në kohën e duhur. Qëllimi ynë është që të bëhet i sigurt fakti se çështjeve të auditimit iu kushtohet rëndësia e duhur dhe çështjet problematike identifikohen dhe trajtohen siç duhet brenda mandatit kushtetues dhe ligjor. Do të kemi parasysh dhe do të bëjmë një përshkrim të natyrës, kohëzgjatjes dhe shtrirjes së procedurave të nevojshme të auditimit. Të njihet entiteti dhe mjedisi ku vepron, përfshirë këtu kontrollet e brendshme, aq mjaftueshëm sa të jemi në gjendje të identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qofshin ato si rrjedhojë e mashtrimeve ose gabimeve, dhe aq mjaftueshëm sa të jemi të aftë të krijojmë dhe kryejmë procedurat e mëtejshme të auditimit.

5.1.1. Rreziqet e auditimit

Për auditimet financiare dhe të pajtueshmërisë, para përgatitjes së planit auditues, vlerësohen rreziqet për të gjitha institucionet. Si pjesë e punës për zhvillimin e planit vjetor të auditimit, ne shqyrtojmë edhe rreziqet potenciale sinjifikante. Rreziqet sinjifikante janë rreziqe të vlerësuara të anomalive materiale që sipas gjykimit të auditorëve kërkojnë vëmendje të veçantë gjatë auditimit, të cilat kanë rezultuar gjatë proceseve individuale të auditimit të OB-ve dhe janë evidentuar në RVA. Në këtë sezonë audituese, përveç çështjeve tjera, vëmendje do t'i kushtohet:

- Keqklasifikimit të shpenzimeve nëpër OB-të;
- Menaxhimit të pasurive financiare;
- Llogarive të arkëtueshme dhe
- Detyrimeve të papaguara dhe kontingjente.
 - Sipas Rregullës financiare nr. 01/2013 - **Shpenzimi i Parave Publike**, shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, të përcaktuara në planin kontabël. Po ashtu, UA 19/2009 për Planin Kontabël kërkon nga ZKA-ja dhe ZKF-ja që të sigurojnë se të gjitha transaksionet janë

regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara në këtë UA.

- Rregullorja MF nr. 02/2013 mbi **Menaxhimin e Pasurive** në Organizata Buxhetore i obligon të gjitha organizatat të mbajnë regjistrat e pasurisë jofinanciare që kanë në menaxhimin e tyre si dhe vazhdimisht të bëjnë azhurnimin e tyre, varësisht nga blerjet/përvetësimet e reja apo shqyrtimit sistematik të gjendjes së tyre të përdorimit.
- Rregullorja MF nr.01/2017 për **Raportim Vjetor Financiar** i obligon OB-të të mbajnë regjistrat e Llogarive të Arkëtueshme. Të arkëtueshmet paraqesin një zë të rëndësishëm për qëllime të menaxhimit financiar. OB-të që mbledhin të hyra janë të detyruara të mbajnë regjistra të shumave të faturuara e të paarkëtuara, të cilat shërbejnë si bazë për raportimin financiar. OB-të janë të detyruara të bëjnë inkasimin e LLA në kohë reale, për faktin se vjetërsia e këtyre llogarive vështirëson inkasimin dhe rrezikon me humbje financiare për OB-të.
- Ligji i buxhetit dhe rregullativa sekondare për **Shpenzimin e Parasë Publike** kufizon hyrjen e OB-ve në detyrime, meqë obligohen që porosinë e mallit/punëve (urdhër blerjen) ta bëjnë vetëm kur ka mjete në dispozicion. Detyrimet e papaguara/kontingjente paraqesin faturat e pranuar për punët/shërbimet e përfunduara nga operatorët ekonomik, por të cilat nuk janë paguar. Për shkak të përdorimit të kontabilitetit në para të gatshme, gjendja e detyrimeve të papaguara vetëm mund të shpaloset në pasqyrat financiare, aq më tepër kur një qasje e tillë e mbledhjes së informatave jashtë SIMFK-së, lë hapësirë për gabime të mundshme në raportimin apo shpalosjen e tyre.

5.1.2. Përgjigjja e Auditimit

Në planifikimin e auditimit do të kemi fokusim të veçantë ndaj këtyre rreziqeve. Si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve do të bëjmë punë shtesë duke dizajnuar një program të veçantë të auditimit për klasifikimin e shpenzimeve, menaxhimin e pasurive, llogaritë e arkëtueshme dhe detyrimet e papaguara/kontingjente.

Ne do të shqyrtojmë sistemet tjera të kontabilitetit dhe kontrollet e menaxhmentit, vetëm aq sa ne e konsiderojmë të nevojshme për të kryer një auditim efektiv. Si rezultat, shqyrtimi ynë mund të mos zbulojë të gjitha mangësitë apo të gjitha përmirësimet që mund të bëhen. Aty ku ne zbulojmë çfarëdo mangësie apo dobësie të rëndësishme, ne do t'i raportojmë me rekomandime për përmirësim.

Në planin vjetor të auditimit, për institucionet e mëdha dhe komplekse, fokusi bëhet te shpërndarja e stafit sipas kualifikimeve, përvojës dhe kompetencës profesionale.

Me qëllim të mbulimit të auditimeve mandatore, krahas burimeve njerëzore, të cilat nuk mund t'i mbulojmë me stafin e rregullt, ZKA-ja bën vlerësimin e rreziqeve për auditimet, ashtu që auditimet me më pak rreziqe kontraktohen nga kompani private të licencuara të auditimit.

5.2. Objektivi i auditimeve të pajtueshmërisë

Objektivi i auditimit të pajtueshmërisë është t'u ofrojë përdoruesve të synuar informacione për atë nëse entitetet publike të audituara i përmbahen ligjeve, akteve legjislative, politikave, udhëzuesve, vendimeve,

kodeve të vendosura, standardeve dhe kushteve të dakorduara të kontratave dhe memorandumeve të mirëkuptimit. Këto auditime kryhen në përputhje me kërkesat në SNISA 400 dhe 4000.

Duke marrë parasysh rëndësinë që aktivitetet si në nivel qendror ashtu edhe atë lokal të kryhen në pajtueshmëri me autoritetet, për sezonin auditues 2025/2026 kemi planifikuar 10 auditime të veçanta të pajtueshmërisë, përderisa 3 auditime janë vazhdimësi e planit të vitit paraparak.

Objektiva dhe fushëveprimi i këtyre auditimeve do të përcaktohen pas analizimit dhe identifikimit të rreziqeve në fusha specifike.

5.3. Objektivi i auditimeve të performancës dhe IT-së

Zyra Kombëtare e Auditimit vazhdon t'i japë rëndësi të veçantë auditimeve të performancës dhe teknologjisë së informacionit.

Për sezonin auditues 2025/2026 do të mbulohen fusha me rëndësi, si:

- barazia gjinore;
- shëndetësia dhe mirëqenia;
- arsimi cilësor;
- industria, inovacioni dhe infrastruktura;
- jeta në tokë;
- qytetet dhe komunitetet e qëndrueshme;
- paqja, drejtësia dhe institucionet e forta;
- konsumi dhe prodhimi i përgjegjshëm/prokurimi publik i qëndrueshëm;
- inovacioni, infrastruktura dhe industrializimi.

Me qëllim të prioritizimit të fushave me interes dhe njëkohësisht maksimizimit të burimeve dhe rritjes së ndikimit përmes auditimeve të performancës në mirëqenien e qytetarëve, Zyra Kombëtare e Auditimit zhvillon një proces deri të përzgjedhja e fushave/temave të auditimit. Procesi ka përfshirë qasjen strategjike dhe hulumtimet për fushat përkatëse, ku është hartuar dhe miratuar strategjia trevjeçare për auditimin e TI-së. Përveç këtyre, janë analizuar raportet e auditimit të rregullsisë apo pajtueshmërisë për identifikimin e mangësive kyçe, si dhe janë ftuar auditorët të propozojnë tema bazuar në njohuritë e tyre dhe problematikat e hasura gjatë auditimeve paraprake.

Përveç hulumtimeve dhe propozimeve nga auditorët e ZKA-së, është organizuar edhe tryezë për të diskutuar me palët e jashtme të interesit, pra me Shoqërinë Civile si OJQ-në, organizatat profesionale, komunitetin e donatoreve dhe ekspertët e fushave, për diskutimin e temave duke u dhënë mundësi pjesëmarrësve për ofrimin e propozimeve.

ZKA-ja synon të promovojë efikasitetin, llogaridhënien, efektivitetin dhe transparencën e administratës publike përmes këtyre auditimeve:



Qëllimi: Barazia gjinore

Fuqizimi i rolit të grave në pozita udhëheqëse dhe në marrjen e vendimeve. Tema e propozuar e auditimit të performancës ka lidhje të drejtpërdrejtë me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 të Kombeve të Bashkuara. Ky është një auditim paralel, i cili do të zhvillohet në nivelin regjional, si bashkëpunim mes Republikës së Shqipërisë, Republikës së Maqedonisë Veriore dhe Republikës së Kosovës, nën mbështetjen e Agjencisë së Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women).

Qëllimi i këtij auditimi është që të përcaktohet nëse janë vendosur politika dhe masa për fuqizimin e rolit të grave në pozita udhëheqëse dhe në pozita të marrjes së vendimeve.



Qëllimi: Shëndet i mirë dhe mirëqenie

Siguria në Shkollat Publike në Kosovë. Siguria e nxënësve është një parakusht themelor për procesin arsimor cilësor dhe për mirëqenien fizike dhe psikologjike të të rinjve. Në Kosovë janë evidentuar shqetësime të vazhdueshme për mungesën e stafit psikologjik, dhunën ndërmjet nxënësve, përfshirjen në substanca të dëmshme, mungesën e infrastrukturës mbrojtëse dhe rrezikun e lartë të bullizimit. Sipas Policisë së Kosovës, gjatë vitit 2022 janë raportuar gjithsej 592 raste të incidenteve në shkolla dhe përreth tyre. Kjo përfaqëson një rritje të konsiderueshme krahasuar me vitet paraprake. Megjithatë, në Sistemin e Menaxhimit të Informatave në Arsim (SMIA), për vitin shkollor 2022/23 janë raportuar vetëm 44 raste të dhunës. Kjo tregon për një mospërputhje të madhe në raportimin e rasteve dhe sugjeron se shumë incidente mund të mbeten të paregjistruara në sistemet zyrtare.

Qëllimi i këtij auditimi është të vlerësohet nëse institucionet arsimore dhe autoritetet publike kanë ndërmarrë masa efektive për të garantuar sigurinë fizike dhe psikologjike të nxënësve në shkollat publike në Kosovë.



Qëllimi: Arsim cilësor

Mbështetja për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në shkollat fillore në Kosovë. Politikat arsimore të vendit gjithnjë e më shumë po orientohen drejt krijimit të kushteve për një arsimim gjithëpërfshirës, përmes trajnimeve të mësimitdhënësve, zhvillimit të planeve individuale arsimore dhe bashkëpunimit me prindërit dhe komunitetin. Numri i vogël i asistentëve që punojnë aktualisht në shkollat publike ka sjellë shumë vështirësi dhe ngecje në nxënie për fëmijët me nevoja të veçanta. Siç është rasti i shkollës "Ismail Qemali" në Prishtinë që ka mbi 60 nxënës që kanë nevojë për mbështetje ndërsa në nivel komunal janë angazhuar vetëm 4 asistentë përgjegjës.

Qëllimi i këtij auditimi është të vlerësojmë nëse institucionet përkatëse kanë ndërmarrë veprime të mjaftueshme dhe efektive për të mundësuar mësim gjithëpërfshirës dhe me cilësi të lartë për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, përmes mësimdhënies së diferencuar, mbështetjes së specializuar

(përfshirë asistentët e mësuesve) dhe infrastrukturës së përshtatshme, duke garantuar njëkohësisht kohë efektive të të nxënit për tërë klasën.



Qëllimi: Industria, Inovacioni dhe Infrastruktura

Monitorimi, mirëmbajtja dhe siguria e digave në Kosovë. Kosova përballlet me sfida të mëdha në menaxhimin dhe sigurimin e burimeve të saj ujore, kryesisht për shkak të potencialit të kufizuar hidroenergetik, burimeve ujore të pakta dhe ndikimeve të ndryshimeve klimatike. Me vetëm 1,600 metër kub ujë për kokë banori, Kosova ka rezervat ujore më të ulëta në rajon. Kjo situatë e vështirë kërkon qasje inovative dhe strategjike për të garantuar furnizimin e qëndrueshëm me ujë dhe energji, si dhe për të parandaluar rreziqet e mundshme.

Ky auditim është auditim paralel me Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe synon të vlerësojë efektivitetin e masave të sigurisë dhe sistemeve të monitorimit të digave në Kosovë, duke e krahasuar atë me praktikën në Shqipëri, me qëllim identifikimin e përmirësimeve të mundshme dhe shkëmbimin e përvojave ndërmjet dy vendeve.

Koogjenerimi - Shtrirja e Rrjetit të Sistemit të Ngrohjes Qendrore. Termokosi ofron shërbime të ngrohjes qendrore për qytetarët dhe bizneset në Prishtinë, duke siguruar shpërndarjen e energjisë termike përmes rrjetit të tij të koogjenerimit dhe stacioneve të shpërndarjes. Megjithatë, Termokosi përballlet me probleme siç janë: shpërndarja jo e balancuar e ngrohjes dhe matja jo e drejtë e konsumit, duke shkaktuar ankesa të shumta nga konsumatorët.

Qëllimi i këtij auditimi është të vlerësohet nëse Ndërmarrja Qendrore Termokos siguron shërbim të ngrohjes cilësorë, të barabartë dhe të qëndrueshëm për konsumatorët, duke menaxhuar në mënyrë efikase dhe transparente matjen dhe zgjerimin e rrjetit.



Qëllimi: Jeta në tokë

Mbjellja e fidanëve dhe taksa ekologjike në komunat e Kosovës. Hapësirat e gjelbra urbane kanë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve, duke ndikuar drejtpërdrejt në shëndetin fizik dhe mendor të popullsisë, mjedisin, biodiversitetin dhe përballjen me ndryshimet klimatike. Në Prishtinë, sipërfaqja e gjelbër për një banor përfshin vetëm 2.5 m², që është shumë herë më e ulët se sa është e përcaktuar sipas standardeve të OBSH-së, ku parashihet që hapësira gjelbëruese të jetë së paku 9 m² për një banorë. Situata e përafërt është edhe në komunat tjera të Kosovës. Në anën tjetër komunat shpenzojnë mjete buxhetore për krijimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra, por rezultatet konkrete në terren janë të pakta.

Qëllimi i këtij auditimi është të vlerësohet nëse komunat dhe institucionet përgjegjëse kanë qenë ekonomike dhe efikase në mbjelljen e fidanëve dhe në krijimin e hapësirave gjelbëruese të nevojshme dhe që përmbushin nevojat e qytetarëve.



Qëllimi: Paqe, Drejtësi dhe Institucione të Forta

Auditim përcjellës (follow-up) për raportet e publikuara të performances për vitin 2020.

Sipas standardeve të auditimit, vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve është një proces i rëndësishëm për të monitoruar nëse subjektet e audituara kanë implementuar rekomandimet e dhëna. Pas publikimit të raporteve, është detyrë e subjekteve të dorëzojnë planet e veprimit dhe të sigurojnë se rekomandimet janë zbatuar në kohë dhe në mënyrë efektive, për të përmirësuar performancën dhe për të adresuar mangësitë e identifikuara.

Qëllimi i këtij auditimi është të kuptojmë pse disa nga institucionet e audituara nuk kanë dorëzuar letër-konfirmimet dhe planet e veprimit sipas afatit kohor, të vlerësojmë nivelin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimeve të performancës të publikuara gjatë vitit 2020 si dhe nëse këto të fundit kanë ndikuar në përmirësimin e gjendjes së identifikuar përmes auditimit.

Këmbimi i Pronave. Në Kosovë, këmbimi i pronave publike me private është bërë një çështje që shpesh shoqërohet me dyshime për shkelje ligjore, mungesë transparence dhe konflikt interesi. Në disa raste është vërejtur se pronat publike janë shkëmbyer me prona private, pa përmbushur kushtet e përcaktuara në ligj dhe pa arsyetuar qartë interesin publik që justifikon një vendim të tillë. Ligji kërkon që këmbimi i pronave komunale të bëhet vetëm nëse sigurohet përfitim i drejtpërdrejtë për komunitetin, pas një procesi transparent dhe me vlerësim profesional të pavarur të pronës, por shpesh këto kërkesa nuk janë respektuar. Problemet kryesore që dalin nga këto raste janë mungesa e konsultimit publik, mungesa e raportit të qartë të interesit publik, mosvlerësimi real i pronave dhe procedurat e përshpejtuara që anashkalojnë kontrollin institucional.

Efektiviteti i verifikimit të Pronave. Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës ka nën administrim prona të cilat jepen me qira. Pronat të cilave u dihet pronari apo bartësi i të drejtës së pronësisë mund të jepen me qira vetëm pas pëlqimit të pronarit/bartësit të së drejtës së shfrytëzimit. Të ardhurat nga qiraja e pronës së braktisur private dhe shoqërore regjistrohen në një llogari të veçantë në ruajtje për pronarin e vërtetë, ndërsa për pronat të cilave u dihet pronari apo bartësi i të drejtës së pronësisë qiraja i paguhet pronarit/bartësit të së drejtës së shfrytëzimit.

Ky auditim synon të sigurojë transparencë dhe llogaridhënie në proceset e administrimit të pronave dhe zbatimit të skemës vullnetare të qirasë, të identifikojë dobësitë në procesin e verifikimit dhe të rekomandojë masa konkrete për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të punës.

Përcjellja e rekomandimeve për raportin e auditimit: "Efikasiteti i menaxhimit të lëndëve civile në gjykatat themelore". Në këtë vlerësim do të shqyrtohet performanca e menaxhimit të lëndëve civile në gjykatat themelore në Prishtinë, Gjiilan, Pejë dhe në Këshillin Gjyqësor të Kosovës duke monitoruar punën e gjyqtarëve dhe burimet e përdorura për zgjidhjen e lëndëve, si dhe vlerësimin e praktikave të aplikuara. Do të vlerësohet standardizimi i procedurave për shpërndarjen e lëndëve, veçanërisht përdorimi i shortit me dokumentim elektronik, si dhe trajnimi i personelit për përgatitjen dhe regjistrimin e lëndëve. Po ashtu, do të analizohet sistemi i pranimi të lëndëve në një bazë të unifikuar elektronike të të dhënave, koordinimi dhe respektimi i afateve për mbajtjen e seancave gjyqësore, përfshirë edhe menaxhimin e shtyrjeve të tyre. Vlerësimi do të përfshijë gjithashtu ndarjen dhe shqyrtimin e lëndëve civile, duke garantuar prioritizimin e drejtë të të gjitha kategorive të lëndëve për një menaxhim të drejtë dhe efikas.

Auditimi synon të sigurojë zbatim të rekomandimeve dhe rritje të transparencës dhe llogaridhënies.



Qëllimi: Qytete dhe komunitete të qëndrueshme

Menaxhimi i mbeturinave të amvisërisë në kryeqytet. Menaxhimi i mbeturinave në Komunën e Prishtinës është funksion me rëndësi të veçantë për mjedisin dhe shëndetin publik. Në një kryeqytet me popullsi në rritje siç është Prishtina, shërbimi i pastrimit nuk është thjesht nevojë por kusht për zhvillim të qëndrueshëm.

Në vitet e fundit, Komuna e Prishtinës është përballur me sfida të konsiderueshme në mbledhjen e mbeturinave të amvisërisë, duke reflektuar performancë të dobët institucionale dhe koordinim të

mangët ndërmjet akterëve përgjegjës. Ky problem është thelluar për shkak të mungesës së një qasjeje strategjike dhe ndryshimeve të shpeshta të politikave dhe rregulloreve të miratuara.

Qëllimi i këtij auditimi është të vlerësojmë nëse Komuna e Prishtinës dhe Kompania Rajonale e Mbeturina - Pastrimi janë efikase dhe efektive në ofrimin e shërbimeve për mbledhjen e mbeturinave në kryeqytet, duke shqyrtuar nëse shërbimi ofrohet në mënyrë të rregullt me përdorim optimal të burimeve financiare, njerëzore dhe materiale.

Banimi i përballueshëm dhe social në Kosovë. Banimi social është i rëndësishëm për të siguruar strehim të dinjitetshëm për familjet me të ardhura të ulëta. Ai kontribuon në zvogëlimin e pabarazive sociale dhe rritjen e mirëqenies në komunitet. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës gjatë vitit 2024 ka nënshkruar disa kontrata për ndërtimin e banesave sociale në disa komuna të Kosovës. Këto projekte synojnë të përmirësojnë kushtet e jetesës për familjet në nevojë dhe të mbështesin zhvillimin social.

Qëllimi i auditimit të këtyre kontratave është të vlerësojë se sa efikase dhe efektive ishte Ministria me Komunitat përkatës në arritjen e synimit kryesor – sigurimin e banimit social për familjet në nevojë.

Përcjellja e rekomandimeve për raportin e auditimit: “Mekanizmat e sigurimit të cilësisë së të dhënave të raportuara për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Grantin e Performancës Komunale për vitin 2021”-DEMOS. Ky auditim është vazhdimësi e bashkëpunimit mes ZKA-së dhe Helvetas-DEMOS-it, që ka filluar në vitin 2019. Në fokus të këtij angazhimi auditues është vlerësimi se si i kanë adresuar entitetet përgjegjëse rekomandimet e dhëna në raportin e fundit të auditimit. Në veçanti do të trajtojmë nëse ka përmirësime në procesin e raportimit dhe vlerësimit të deklaramit të performancës komunale, duke siguruar transparencë, përgjegjshmëri dhe efektivitet në të gjitha nivelet e përfshira.

Subjektet e këtij auditimi janë komunat: Gjakovë, Klinë dhe Viti, të cilave iu kemi rekomanduar që të sigurojnë kanale të qarta të komunikimit, të vendosin proces sistematik për miratimin e të dhënave dhe të zhvillojnë mekanizma të kontrollit për cilësinë e informacionit të raportuar. Subjekt tjetër i këtij auditimi është Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, të cilës i kemi rekomanduar që të adresojë mangësitë në pranimin dhe verifikimin e të dhënave, të zbatojë rregulloret për menaxhimin e qasjes në Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK), si dhe të organizojë trajnime për menaxhimin e llogarive dhe proceset e rishikimit.

Auditimi synon të sigurojë zbatim të rekomandimeve dhe rritje të transparencës dhe llogaridhënies.

Lejet e Ndërtimit në Komunën e Ferizajt. Qyteti i Ferizajt është përballur me rritje të shpejtë të popullsisë, e pasuar natyrisht me rritje të kërkesave për banim, e që ka sjellë zhvillim të hovshëm në sektorin e ndërtimeve të larta. Numri i madh i aplikimeve për leje ndërtimore paraqet sfidë për Komunën, si në aspektin e shqyrtimit të aplikimeve ashtu edhe në aspektin e kontrollit të veprimeve të investitorëve që kanë marrë leje për ndërtim.

Auditimi do të vlerësojë nëse ndërtimet e larta janë në përputhje me planet zhvillimore, hartat zonale ose planet rregulluese, si dhe nëse procesi i lëshimit të lejeve të ndërtimit ishte efektiv, transparent dhe

i orientuar ndaj nevojave të qytetarëve dhe investitorëve. Gjithashtu do të shqyrtohet nëse Komuna ka mekanizma të mjaftueshëm për t'u mundësuar qytetarëve përdorim efektiv të pronave të tyre.



Qëllimi: Konsum dhe prodhim i përgjegjshëm/prokurim publik i qëndrueshëm

Shërbimet e Arkitektit të Kryeqytetit. Komuna e Prishtinës ka nënshkruar kontratën kornizë trevjeçare “Shërbimet e Arkitektit të Kryeqytetit” në vlerë prej 12 milion euro. Përmes kësaj kontrate Komuna synon të sigurojë projekte ndërtimore të cilat do t'i përdorë për zhvillimin e infrastrukturës publike në kryeqytet.

Auditimi do të vlerësojë sa efektive ishte Komuna në arritjen e synimeve të saj, duke analizuar nëse janë siguruar objektivat e planifikuara. Përveç kësaj auditimi do të vlerësojë nëse procesi i prokurimit është zhvilluar në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke respektuar parimet e transparencës dhe trajtimit të barabartë të ofertuesve. Gjithashtu do të vlerësojmë se si është menaxhuar kontrata dhe a ka arritur objektivat e synuara, përfshirë hartimin e kornizës së unifikuar të planifikimit, krijimin e sistemit të informacionit gjeografik (GIS), përgatitjen e rregulloreve dhe manualeve për planifikim, si dhe trajnimin e stafit komunal në përdorimin e mjeteve moderne të planifikimit. Për më tepër, do të vlerësojmë nëse kontrata ka kontribuar në përsheptimin e zbatimit të projekteve komunale, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe teknike, si dhe në krijimin e një identiteti urban më koherent për qytetin.

Auditimi synon të sigurojë llogaridhënie më të madhe të Komunës së Prishtinës në menaxhimin e projekteve strategjike dhe të rekomandojë masa për përmirësimin e transparencës, efektivitetit dhe besimit të qytetarëve dhe investitorëve në proceset e planifikimit urban.

Përdorimi i kriterit Tenderi Ekonomikisht më i Favorshëm (TEMF). Autoritetet kontraktuese, në shumicën e aktiviteteve të prokurimit publik, e përdorin kriterin “çmimi më i ulët” kur i vlerësojnë ofertat e ofertuesve. Kriteri tjetër për dhënie të kontratës, Tenderi Ekonomikisht më i Favorshëm (TEMF), përdoret shumë rrallë, ndërsa njësitë kërkuese vazhdimisht kanë kërkuar që të përdoret TEMF, sidomos në kontratat për punë, nën supozimin se përdorimi i këtij kriteri do të sigurojë cilësi më të lartë të punëve dhe materialeve.

Qëllimi i këtij auditimi është që të vlerësojmë se sa është përdorur ky kriter dhe a është përdorur në atë mënyrë që të ndikojë në përmirësimin e cilësisë së blerjeve.

Prokurimi dhe zbatimi i masave të efijencës së energjisë në ndërtesat publike. Kosova ka ndërmarrë një program të gjerë për rritjen e efikasitetit të energjisë në ndërtesat publike, i cili mbështetet me fonde të konsiderueshme nga donatorë ndërkombëtarë dhe nga buxheti i Kosovës. Ky projekt përfaqëson një nismë me rëndësi të lartë në aspektin strategjik dhe financiar për shkak të investimeve të mëdha dhe ndikimit të tyre afatgjatë. Kosova ka siguruar rreth 86 milion euro përmes kredive dhe granteve, për të rinovuar mbi 400 ndërtesa publike deri më 2031, me synim uljen e konsumit të energjisë 30-50%. Megjithatë, një pjesë e fondeve është pezulluar nga BE-ja për shkak të parregullsive, duke ngritur shqetësime për procesin e prokurimit dhe menaxhimin e projekteve.

Qëllimi i auditimit është të vlerësojë se sa efektive dhe efikase ka qenë Qeveria në zbatimin e masave të efijencës së energjisë në ndërtesat publike, si dhe të vlerësojë se a janë zhvilluar proceset e prokurimit

në përputhje me parimin e ekonomisë. Auditimi synon të ndihmojë në identifikimin e mangësive në aspektin ligjor, parandalimin e humbjeve financiare, si dhe të kontribuojë në sigurimin e besimit të donatorëve dhe qytetarëve në menaxhimin e fondeve publike dhe ndërkombëtare.



Qëllimi: Inovacioni, Infrastruktura dhe Industrializimi, duke përmirësuar transparencën, përgjegjshmërinë dhe efikasitetin e institucioneve publike përmes integritetit të sistemeve dhe avancimit të infrastrukturës teknologjike në administratën financiare.

Sistemi i Integruar Informativ për Skemat Pensionale. Përmes Sistemit të Integruar Informativ (SII) administrohet baza e të dhënave për 11 skemat pensionale, pra procesi nga aplikimi për pension e deri te pranimi apo refuzimi i kërkesës, si dhe procedurat e pagesës, lajmërimi i pensionistëve, aktivizimi etj. Për këtë kategori, në vitin 2024 ishte ndarë buxhet rreth 430 milion euro.

Qëllimi i këtij auditimi është të vlerësohet nëse Sistemi i Integruar Informativ për Skemat Pensionale funksionon në mënyrë efektive për administrimin e skemave pensionale, duke siguruar të dhëna të sakta, me shërbime efikase të digjitalizuara e në kohë reale.

Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Studentëve. Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Studentëve (SEMS) është sistemi kryesor dhe unik në kuadër të sistemit shtetëror, i cili mundëson menaxhimin e aktiviteteve të studentëve. Aplikimi i këtij sistemi ka filluar në vitin 2012 për të gjithë studentët e Universitetit të Prishtinës. Nga statistikat e përgjithshme të SEMS-it janë rreth 151 mijë përdorues aktivë, rreth 4.9 milion fletëparaqitje si dhe afër 1 milion pagesa. SEMS-i ofron modulet e profesorit, studentit, diplomave, pagesave, modulën për regjistrimin e orarit mësimor, modulën për paraqitjen e provimeve, etj.

Qëllimi i këtij auditimi është të vlerësohet nëse SEMS-i kryen funksionin për të cilin është zhvilluar dhe nëse ju mundëson studentëve të realizojnë shërbimet në mënyrë të sigurt, të saktë dhe transparente.

Sistemi për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë. Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve (ARBK) është institucioni kryesor për regjistrimin dhe administrimin e bizneseve në Kosovë, duke vepruar nën Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. ARBK-ja ofron një sistem elektronik modern që thjeshton procesin e regjistrimit për bizneset e reja dhe ekzistuese, duke mundësuar shërbime të shpejta, të qasshme dhe pa kosto për fillimin e aktivitetit ekonomik.

Përmes rrjetit të 34 qendrave komunale të regjistrimit, të lidhura me zyrën qendrore të ARBK-së, ofrohet një shërbim i unifikuar ("one-stop-shop") dhe i koordinuar në të gjithë territorin e Kosovës.

Përveç regjistrimit të të dhënave me vlerë për bizneset dhe menaxhimin e monitorimit më të lehtë të tyre, ky sistem zvogëlon shpenzimet dhe rrit sigurinë dhe besueshmërinë e të dhënave edhe për platformat tjera, të cilave u nevojiten të dhënat e bizneseve.

Qëllimi i këtij auditimi është vlerësimi i kontrolleve të aplikacionit për Sistemin e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës, ndërlidhja e tij me sistemet e tjera për të dhënat që i ofron dhe duhet t'i pranojë ky sistem në raport me sistemet e tjera.

6. BUXHETI DHE BURIMET NJERËZORE

ZKA-ja është institucion i pavarur, i cili financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës i cili miratohet nga Kuvendi i Kosovës, sipas procedurës së përcaktuar me Ligjin 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Bazuar në Ligjin e Buxhetit për vitin 2025, mjetet e ndara për ZKA-në janë 3,532,633€. Krahësuar me Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2024, buxheti shënon një rritje të lehtë rreth 5.6%. Buxheti është i ndarë në katër kategori ekonomike: Paga dhe mëditje, Mallra dhe shërbime, Shërbime komunale dhe Investime kapitale.

Me buxhetin vjetor janë miratuar 185 vende pune, aktualisht ka të punësuar 177 punonjës, prej të cilëve 134 janë të angazhuar drejtpërdrejt në auditim, kurse pjesa tjetër në shërbimet tjera menaxheriale, administrative dhe mbështetëse.

Për të arritur qëllimet dhe objektivat strategjike, ZKA-ja është duke investuar në zhvillimin e vazhdueshëm profesional të burimeve njerëzore. Punonjësve auditues do t'iu mundësohet vijimi i trajnimeve dhe arritja e normativit të përcaktuar në SNISA-t për arsimin e vazhdueshëm profesional, si një nga faktorët themelorë për kryerjen e auditimeve me kompetencë, cilësi dhe sipas kërkesave të SNISA-ve.

Duke marrë parasysh kërkesat për auditime, rritjen e portofolit të auditimeve dhe shtimin e numrit të auditimeve të pajtueshmërisë, numri i auditorëve nuk është i mjaftueshëm për t'i mbuluar të gjitha këto auditime.

Në mungesë të burimeve të mjaftueshme dhe me qëllim të orientimit të burimeve në fushat me rrezik, ZKA-ja është e detyruar që çdo vit të kontraktojë kompani private të auditimit për të përkrahur auditimin financiar të detyrueshëm me ligj të një numri të caktuar të organizatave buxhetore.

7. ZBATIMI I PLANIT VJETOR

Plani vjetor i auditimit do të zbatohet nga 1 shtatori 2025 deri më 31 gusht 2026.

Për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara, ZKA-ja përgatit plane operative audituese, sipas fushave, organizatave buxhetore dhe projekteve të caktuara, shumave të buxhetit, si dhe për përbërjen e stafit për realizimin e planit në këtë sezonë audituese, duke u mbështetur nga sistemi i teknologjisë së informacionit për kryerjen e auditimit-SITA.

Mbi këtë bazë, ZKA-ja përgatit edhe planin kohor për përfundimin e sezonit auditues për secilin projekt auditues, i cili inkorporohet në SITA dhe realizimi i tij monitorohet në vazhdimësi.

Prishtinë, tetor 2025

Vlora Spanca

Auditore e Përgjithshme

Shtojca 1. Subjektet/temat dhe shuma e buxhetit që do të auditohet.

AUDITIMET FINANCIARE DHE TË PAJTUESHMERISË

Tabela 1. Institucionet e nivelit qendror dhe lokal, ndërmarrjet publike dhe projektet që financohen nga huamarrja shtetërore dhe nga donatorët

Institucione të nivelit qendror/RVA [1 + 49+3 = 53]

	Entitetet nën auditim	Buxheti 2025 (në €)
1	Raporti Vjetor i Buxhetit të Republikës së Kosovës	3,538,893,264
1	Kuvendi i Kosovës	11,701,185
2	Zyra e Presidentit	6,134,519
3	Zyra e Kryeministrit	21,308,710
4	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës)	1,019,101,596
	<i>Klauzola e Investimeve</i>	2,000,000
5	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	9,168,745
6	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	90,490,506
7	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	28,570,046
8	Ministria e Ekonomisë	34,335,294
	<i>Klauzola e Investimeve</i>	5,950,000
9	Ministria e Shëndetësisë	76,347,513
	<i>Klauzola e Investimeve</i>	7,075,200
10	Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës	190,656,752
11	Fondi i Sigurimeve Shëndetësore	10,987,998
12	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	86,399,046
13	Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	98,963,750
	<i>Klauzola e Investimeve</i>	1,000,000
14	Universiteti i Prishtinës	34,150,641
15	Ministria për Komunitet dhe Kthim	6,700,694
16	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	259,396,874
	<i>Klauzola e Investimeve</i>	53,071,452

17	Ministria e Punëve të Brendshme	227,320,094
	<i>Klauzola e Investimeve</i>	6,413,875
18	Auditimi i Informatave të Klasifikuara në MPB	
19	Ministria e Drejtësisë	57,221,749
20	Auditimi i Informatave të Klasifikuara në MD	
21	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	49,496,776
22	Ministria e Mbrojtjes	207,875,243
23	Auditimi i Informatave të Klasifikuara në MM	
24	Ministria e Zhvillimit Rajonal	7,130,526
25	Këshilli Prokurorial i Kosovës	18,913,922
26	Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve	1,566,882
27	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	36,062,871
28	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik*	882,455
29	Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës	1,715,902
30	Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare*	1,636,914
31	Agjencioni për Parandalimin e Korrupsionit*	1,099,235
32	Zyra e Rregullatorit për Energji	1,148,610
33	Organi Shqyrtues i Prokurimit	539,193
34	Gjykata Kushtetuese e Kosovës	2,335,323
35	Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës*	464,828
36	Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor	364,366
37	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa	262,421
38	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës*	612,381
39	Autoriteti Rregullator i Shërbimeve të Ujit	504,426
40	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	436,599
41	Autoriteti i Aviacionit Civil	858,966
42	Komisioni i Pavarur i Mediave	1,386,137
43	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	22,327,635
44	Institucioni i Avokatit të Popullit	1,451,622
45	Akademia e Drejtësisë*	864,973
46	Agjencia Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës	2,933,439
47	Agjencia për Informim dhe Privatësi	495,563

48	Fondet në Mirëbesim	-
49	Agjencioni Kosovar i Privatizimit	5,111,731
50	Agjencioni për Shërbimet e Navigimit Ajror	10,349,557
51	Agjencioni për Mbrojtjen e Informacionit të klasifikuar	921,388
52	Radio Televizioni i Kosovës (PVF)	8,960,000

**Institucionet e Pavarura, 6 auditime të cilat do të përkrahen nga kompania private e auditimit.*

Institucione të nivelit Lokal/Komuna [38]

	Entitetet nën auditim	Buxheti 2024
1	Prishtinë	122,699,999
	<i>Klauzola e Investimeve</i>	1,000,000
2	Obiliq	14,516,132
3	Podujevë	33,459,115
4	Fushë Kosovë	16,747,839
5	Mitrovicë	30,240,512
6	Graçanicë	9,753,348
7	Mitrovica e Veriut	6,512,368
8	Zubin Potok*	3,377,704
9	Zveçan*	3,102,270
10	Prizren	68,852,476
	<i>Klauzola e Investimeve</i>	1,500,000
11	Mamushë*	2,718,408
12	Malishevë	21,576,545
13	Rahovec	20,982,796
14	Lipjan	24,897,038
15	Shtime	10,777,180
16	Suharekë	23,284,922
17	Shtërpçë*	4,777,735
18	Klllokot*	1,429,786
19	Gjilan	37,189,018
20	Viti	17,945,622
21	Novobërdë*	4,284,877
22	Ferizaj	46,013,005
23	Klinë	16,168,653
24	Pejë	39,842,382
25	Istog	15,937,257
26	Glllogoc	22,133,550
27	Skenderaj	19,881,472
28	Vushtrri	27,662,762

29	Gjakovë	40,584,369
30	Deçan*	14,401,935
31	Dragash*	12,872,214
32	Junik*	2,340,142
33	Kamenicë*	15,282,624
34	Leposaviq*	6,082,192
35	Partesh*	1,750,440
36	Ranillugë*	2,399,549
37	Kaçanik	12,592,238
38	Hani i Elezit*	3,615,457

*Institucionet lokale, 14 auditime të cilat do të përkrahen nga kompania private e auditimit.

Auditime të pajtueshmërisë [10]*

*Temat për auditim të pajtueshmërisë, identifikohen gjatë procesit të auditimeve të rregullta.

Auditime të pajtueshmërisë në proces [3]

Temat në proces auditimi	
1	Ndërtimi i Objektivit për Klinikat Nefrologji dhe Hemato-Onkologji në ShSKUK
2	Thirrjen publike për subvencionimin e ndërtimit të shtëpive për pjesëtarët e komuniteteve pakicë në komunat: Mitrovicë Veriore, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok
3	Menaxhimi i projekteve kapitale në fushën e trashëgimisë kulturore në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

Ndërmarrje publike [12]

Entitetet nën auditim	
1	Korporata Energjetike e Kosovës, sh.a (KEK)
2	Pasqyrat për qëllime të veçanta të KEK-ut për nevoja të ZRRE-së
3	Pasqyrat për qëllime të veçanta të KEK-ut për nevoja të KPMM-së
4	KOSTT
5	Stacioni i autobusëve-Prishtinë
6	Trepça Sh.A
7	KRU "Prishtina" sh.a - Prishtinë
8	KRM "Uniteti" sh.a – Mitrovicë
9	Ngrohtorja Qendrore "Termokos" - Prishtinë
10	NPH "Ibër - Lepenc" sh.a – Prishtinë
11	Hidrodrini sh.a -Pejë
12	KRM-Pastërtia-Ferizaj

Projekte që financohen nga huamarrja shtetërore dhe nga donatorët [6]

Projektet/Entitetet nën auditim	
1	Projekti i Reformës së Sistemit të Asistencës Sociale (BB-MFPT)
2	Ekonomia Digjitale e Kosovës (BB-MPB/ASHI)
3	Përmirësimi dhe Rehabilitimi i Sistemeve të Ujitjes në Kosovë (BB-MBZHR)
4	Projekti për Infrastrukturën e Pasurive të Paluajtshme dhe Gjeohapësinore (BB-AKK)
5	Programi për nxitjen dhe shfrytëzimin e mundësive për sigurinë e ujit (BB-MMPHI/Hidromorava)
6	Arsimi dhe kujdesi i fëmijërisë së hershme për projektin e kapitalit njerëzor të Kosovës (BB-MASHT)

B. AUDITIMET E PERFORMANCËS

Tema të auditimeve të performancës [20]

Temat nën auditim	
1	Fuqizimi i rolit të grave në pozita udhëheqëse dhe në marrjen e vendimeve
2	Auditim Përcjellës (Follow-up) për raportet e publikuara të performancës për vitin 2020*
3	Siguria e nxënësve në shkollat e mesme dhe të ulëta publike në Kosovë
4	Mbjellje të fidanëve nëpër komuna dhe taksa ekologjike
5	Koogenerimi-Shtrirja e Rrjetit të Sistemit të Ngrohjes Qendrore
6	Këmbimi i pronave*
7	Mbështetja e nxënësve me nevoja të veçanta në arsimin fillor
8	Shërbimi i Arkitektit të Kryeqytetit
9	Efektiviteti për verifikimin e pronave
10	Përcjellja e rekomandimeve - Lëndët Civile në Gjykata Themelore
11	Lejet e ndërtimit në Komunën e Ferizajt
12	Prokurimi dhe zbatimi i masave të efikasitetit të energjisë në ndërtesat publike
13	Banimit i Përbalueshëm dhe Social në Komuna
14	Përdorimi i TEMF*
15	Temë e re
16	Sistemi i Integruar Informativ(SII) për skemat pensionale
17	Sistemi i Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (RBK)*
18	Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Studentëve (SEMS)
19	Temë e re
20	Mbledhja e mbeturinave në Komunë të Prishtinës

*Temat të cilat do të vazhdojnë edhe pas sezonit aktual auditues

Tema të auditimeve të performancës në proces [3]

Temat në proces auditimi	
1	DEMOS
2	Furnizimi me barna për shëndetësinë primare dhe sëmundjet e rralla
3	Siguria e Digave

Zyra Kombëtare e Auditimit
Lagjja Arbëria
Rr. Ahmet Krasniqi, 210
10000 Prishtina
Republika e Kosovës

